

VENDIM
Nr. 1327, datë 11.9.2026

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E NENEVE 4 DHE 9, TË LIGJIT NR. 9121/2003, NË SEKTORIN E TRANSPORTIT DETAR, PËRFSHIRË KABOTAZHIN DHE SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË LUNDRIMIT TË LIRË (*TRAMP SERVICES*)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen, e:

Z. Denar Biba	kryetar;
Znj. Leida Matja	zëvendëskryetar;
Znj. Rezana Konomi	anëtar;
Z. Durim Kraja	anëtar;
Znj. Fatjola Delija	anëtar,

në mbledhjen e tij të datës 11.9.2026, shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Mbi miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (*tramp services*)”

BAZA LIGJORE: Neni 24, shkronja “d” dhe neni 26, i ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draftrregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (*Tramp services*)”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (*Tramp services*)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Kryetar: Denar Biba

Zëvendëskryetar: Leida Matja

Anëtarë: Rezana Konomi, Durim Kraja, Fatjola Delija

RREGULLORE

“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E NENEVE 4 DHE 9, TË LIGJIT NR. 9121/2003, NË SEKTORIN E TRANSPORTIT DETAR, PËRFSHIRË KABOTAZHIN DHE SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË LUNDRIMIT TË LIRË (*TRAMP SERVICES*)”¹

¹ Ky akt është përafuar me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1419/2006, datë 25 shtator 2006, që shfuqizon Rregulloren (EEC) nr. 4056/86, e cila përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e neneve 85 dhe 86, të Traktatit në transportin detar, dhe ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1/2003, lidhur me zgjerimin e fushës së zbatimit të saj për të përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (*Tramp services*).

Neni 1

Dispozitat që lidhen me marrëveshjet, vendimet dhe praktikat e bashkërenduara në sektorin e transportit detar zbatohen për të gjitha format e shërbimeve detare, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të anijeve të lundrimit të lirë, në përputhje me nenet 4 dhe 9, të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Neni 2

Autoriteti i Konkurrencës ushtron kompetencat e tij për hetimin e shkeljeve të konkurrencës dhe vendosjen e masave përkatëse administrative, në përputhje me ligjin nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin e saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.